



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Kom.Dh.Shk.II.nr.546/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Fox Marble Kosova Sh.P.K., me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Eset Berisha avokat me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.T.Sh. Dino, Sh.P.K., me seli në Konjuh, Magjistratja Prishtinë-Ferizaj, të cilën me autorizimi e përfaqëson Egzona Gashi, avokate nga Lipjani, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.13/20 të datës 21.12.2022, me datë 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit N.T.Sh. Dino, Sh.P.K., me seli në Konjuh, Magjistratja Prishtinë-Ferizaj, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan- Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.13/20 të datës 21.12.2022 dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan- Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e atakuar PPP.nr.13/20 të datës 21.12.2022, në dispozitiv, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit N.T.Sh. Dino, Sh.P.K., me seli në Konjuh, Magjistratja Prishtinë-Ferizaj, kundër urdhërin përmbarimor P.nr.12/20 e datës 23.01.2020 të përmbaruesit privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, dhe e ka lënë në fuqi urdhërin përmbarimor.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori N.T.Sh. Dino, Sh.P.K., me seli në Konjuh, Magjistralja Prishtinë-Ferizaj, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan- Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.13/20 të datës 21.12.2022, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit, duke e kundërshtuar Aktvendimin PPP.nr.13/20 të datës 21.12.2022 dhe të anulohet urdhëri përmbarimor.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, me datën 22.01.2020 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarimit, kundër debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave për shumën e borxhit prej 50,453.74 €.

Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit e ka caktuar urdhrin P.nr.12/20 e datës 23.01.2020, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. X125 të datës 24.10.2017 dhe Nr. X144 të datës 12.12.2017, me të cilat i ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumën prej 50,453.74€ me kamatë ligjore 8% në vit si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbarimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbarimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan- Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e atakuar PPP.nr.13/20 të datës 21.12.2022, në dispozitiv, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e

debitorit N.T.Sh. Dino, Sh.P.K., me seli në Konjuh, Magjistralja Prishtinë-Ferizaj, kundër urdhërin përbarimor P.nr.12/20 e datës 23.01.2020 të përbaruesit privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, dhe e ka lënë në fuqi urdhërin përbarimor.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret Faturës Nr. X125 të datës 24.10.2017 dhe Nr. X144 të datës 12.12.2017, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dokumenti - Faturës Nr. X125 të datës 24.10.2017 dhe Nr. X144 të datës 12.12.2017, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përbarim, i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se faturat në rastin konkret i përmbanë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm, meqenëse janë treguar palët , debitori kreditori, janë përshkruar shërbimet, shuma dhe janë pranuar nga ana e debitori, përkatësisht e njëjta përmban nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe ka dëshmi se fatura është pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e po ashtu fatura përmban kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, si e tillë e njëjta mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe ka tipare të përbarueshmërisë. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivi të këtij aktvendimi të atakuar.

Gjykata Komerciale qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë nuk mund ta pranoj qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, për faktin se kjo e fundit gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike kur e ka aprovuar kërkesën e debitorit , me arsyetimin se sipas Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së dyte, gjykata e shkallës së parë nuk e ka arsyetuar me prova konkret dhe se nga shkresat e lëndës nuk gjen mbështetje se fatura është pranua nga debitori dhe janë sipas LPP-së, duke mos e mbështetur në asnjë prove, por vetëm duke e arsyetuar se rrjedhin nga kontratat që kanë pasu ndërmjet palëve ndërgjyqjësë, për periudhën që është anashkaluar nga ekspertiza financiare dhe fare nuk është cekur. Kjo Gjykate nuk mund ta pranoj qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me këtë qëndrim, sepse duke analizuar provat nga shkresat e lëndës rezulton se debitorit e ka bërë të besueshëm kërkesën për kundërshtimin e faturave, të cila janë të njëanshme dhe mungon

nënshkrimi apo pranimi nga ana e debitorit dhe nuk lidhe me asnjë nga marrëveshjet apo porosit në librat e kontabilitetit të debitorit. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vendosur në këtë çështje, sepse gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, duke mos pasur fare parasysht ekspertizën financiare të datës 14.10.2022 duke u bazuar edhe konstatuar në 5 faqe sqarim të ekspertizës, në të cilën nuk ekziston borxhi faktik. Prandaj e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr.149/20 të datës 09.03.2020, dhe e ka lënë në fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.12/20 e datës 23.01.2020 të përmbaruesit privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë.

Mos vërtetimi i validitetit të provave kontestuese, si prova të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, përbejnë shkelje të dispozitës së Nenit 183.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare”*.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga Nenit 183.1 dhe Neni 160 par. 3 dh 4 të LPK-së, që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë dhe si rrjedhojë gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale, aplikimin e drejtë të secilës në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjykata e shkallës së dytë e vlerëson sipas detyrës zyrtare, andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të prishet.

Në ri-procedurë gjykata e shkallës së parë duhet evituar shkeljet e theksuara më lartë, në atë mënyrë që të eviton kundërthëniet ekzistuese në mes dispozitivit me arsyetimin, arsyetimit me faktet vendimtare dhe me arsyet e theksuara për çështjet kryesore dhe sipas nevojës të nxjerrë provat e nevojshme për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ta vërtetojë ekzistimin apo jo të detyrimit të ndërsjellë të palëve dhe lartësinë e detyrimit dhe pas kësaj të vendos, duke marrë vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vlerësojë edhe njëherë pretendimet e palës debitorë lidhur me prapësimin e tij, respektivisht të vlerësojë se a janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbarimit nga ana e përmbaruesit privat, si dhe a është provuar nga ana e debitorit për lirimin nga borxhi, dhe fatura e lartëcekura a janë të pranuar në të vërtet nga debitori dhe a ekzistojnë në librat e kontabiliteti të

debitorit, lidhur me porosinë e mallit ndaj kreditorit. Gjithashtu të vërtetohet edhe një herë ekspertiza financiare që të jetë sa më e saktë dhe e kuart në arsyetimin e saj, dhe më pastaj ka mundësi që të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Kom.Dh.Shk.II.nr. 546/23 dt. 05.06.2024,

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj-Sheremeti.